

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6749
E premte, 4 nëntor 2022
çmimi 0.40 €

Haradinaj, letër Kurtit:
Pranojeni kërkesën
e ShBA-së për shtyrjen e
vendimit për targat | **FAQE 3**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

LIDERËT E BALLKANIT PERËNDIMOR NËNSHKRUAJNË TRI MARRËVESHJE NË KUADËR TË PROCESIT TË BERLINIT. | **FAQE 4-5**



Liderët e Kosovës, të Shqipërisë, të Bosnjë-Hercegovinës, të Malit të Zi, të Maqedonisë së Veriut dhe të Serbisë kanë nënshkruar tri marrëveshje për njohjen reciproke të letërnjoftimeve, të diplomave universitare dhe të kualifikimeve profesionale në kuadër të samitit të Procesit të Berlinit që po mbahet

më 3 nëntor. Marrëveshjet e nënshkruara pas gati dy vjet negociatash, duhet fillimisht të ratifikohen para se të hyjnë në fuqi, ka njoftuar Qeveria e Kosovës. Marrëveshja për njohjen reciproke të letërnjoftimeve mundëson lëvizjen e lirë, pa viza, edhe në të mes Kosovës dhe Bosnjë-Hercegovinës

PRESIDENTJA INJOROI SPITALIN PUBLIK, I NËNÇMOI EDHE MJEKËT



Më 2 nëntor presidentja e vendit, Vjosa Osmani, i është nënshtruar një intervenimi kirurgjik (heqja e tëmthit) në spitalin privat "Aloka". Por ky veprim i presidentes për ta zgjedhur spitalin privat për operim dhe jo atë publik ka ngjallur reagime të shumta nga shoqëria civile dhe profesionistët shëndetësorë | **FAQE 7**



LIMAJ AFËR PDK-SË, PI ÇAJ ME
NURËN DHE LUSHTAKUN | **FAQE 8**

**OSMANI: MARRËVESHJET E ARRITURA
NË KUADËR TË PROCESIT TË
BERLINIT, PËRAFRIM ME BE-në | **F. 3****

**IPK-ja REKOMANDON SUSPENDIMIN
E DREJTORIT TË POLICISË NË VERI | **F. 3****

**SULMOHET STACIONI POLICOR
KUFITAR NË ZUBIN POTOK | **F. 6****

**MAZREKU VAZHDON LOBIMIN
PËR ANËTARËSIM NË BYRONË
E KARTONIT TË GJELBËR | **F. 8****

**BANKA E SHQIPËRISË NË LUFTË ME
INFLACIONIN, RRIIT SËRISH NORMËN
E INTERESIT | **F. 8****

SPORT



**KOSOVA ME SHUMË NDRYSHIME NË
NDESHJET E NËNTORIT | **F. 10****

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Vuçiqi: Dronët mbi ndërtesat ushtarake janë një lloj agresioni

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Presidenti serb Aleksandër Vuçiq tha se Serbia "nuk është në konflikt me askënd", por nuk mund të lejojë që dikush ta spiunojë ushtrinë e saj. Duke komentuar rrëzimin e një droni pranë ndërtesave ushtarake afër Rashkës në jug të Serbisë, Vuçiqi tha se kjo nuk është hera e parë që fluturake pa pilot janë hasur mbi ndërtesa ushtarake të forcave të armatosura serbe dhe se kjo përbën "një lloj agresioni". "I kemi detektuar ditë më parë dhe ne i paralajmëruam ata. Ky lloj vëzhgimi dhe puna e paligjshme e inteligjencës përbën një lloj agresioni kundër një shteti sovran", tha Vuçiqi për gazetaret gjatë vizitës në një qendër stërvitore ushtarake ku po zhvillohen stërvitjet "Manovrat 2022". Vuçiqi tha se "po punohet" për të përcaktuar se kush e ka operuar dronin komercial që ushtria serbe tha se e rrëzoi më 2 nëntor afër garnizonit të ushtrisë serbe në Rashkë. "Ata përdorën dron komercial duke menduar se nuk mund të zbulohet se kush është pronari i tij dhe kush qëndron pas këtyre veprimeve të paligjshme", tha Vuçiqi.

Sa i përket këtij incidenti, Vuçiqi tha se "aktiviteti i përbashkët kundër Serbisë është menjëherë i dukshëm". "Nuk do ta quaja armiqësor sepse ka konotacion tjetër në shtet dhe rajon. Ne nuk jemi në konflikt me askënd, por a do të dëshironit që dikush ta spiunojë ushtrinë tonë, të hyjë në çdo hangar në territorin e Serbisë qendrore dhe të numërojë çdo plumb dhe granatë që kemi", tha Vuçiqi. Ai shtoi se më 2 nëntor dronët e NATO-s "kanë qarkulluar gjatë gjithë ditës në Bërnjak dhe Jarinjë", që janë pikat kufitare që lidhin Kosovën me Serbinë. "Ata ishin 200 deri në 500 metra larg vijës administrative. NATO në këtë rast i ndoqi të gjitha procedurat. I pamë dhe nuk patëm asnjë problem, por ne kemi të drejtë t'i rrëzojmë dronët në përputhje me Rezolutën 1244 dhe me Marrëveshjen e Kumanovës", tha Vuçiqi. Më 1 nëntor Vuçiqi urdhëroi rritjen e gatishmërisë luftarake të ushtrisë serbe. Ministri serb i Mbrojtjes, Milosh Vuçević, tha se gatishmëria ushtarake u rrit për shkak se dronë nga Kosova hynë në Serbi dhe vëzhguan pozicionet dhe



ndërtesat e ushtrisë serbe. Kosova ka mohuar se dronët kanë shkuar nga territori i saj në Serbi. Ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Armend Mehaj, tha më 1 nëntor se këto pretendime po bëhen për

të përhapur panik në mesin e qytetarëve. Urdhri i Vuçiqit për rritjen e gatishmërisë ushtarake erdhi në ditën kur në Kosovë nisi zbatimi i planit të Qeverisë së Kosovës për

riregjistrimin e makinave me targa të lëshuara nga Serbia. Kosova i konsideron ilegale targa të lëshuara nga Serbia, por deri më tani i ka toleruar ato në veri të Kosovës.

Koreja e Veriut lëshon edhe një raketë balistike



PHENIAN, 3 NËNTOR - Koreja e Veriut lëshoi një raketë balistike ndërkontinentale (ICBM) të enjten, por ajo dështoi në mes të fluturimit, thotë ushtria e Koresë së Jugut. Kjo raketë balistike është e shtata që ka lëshuar Pheniani këtë vit. Kjo ndodhi në mes të

shqetësimeve se së shpejti verikoreanët do të testojnë një armë bërthamore. Tensionet vijnë një ditë pasi dy Koretë lëshuan për herë të parë raketa afër brigjeve të njëra-tjetrës. Seuli ka vepruar në shenjë

hakmarrjeje tri orë pasi Pheniani ka nisur një raketë që ka rënë më pak se 60 kilometra larg qytetit jugkorean Sokço. Lëshimi i raketave nga Koreja e Veriut u bë pasi ShBA-ja dhe Koreja e Jugut po organizojnë stërvitjet e përbashkëta

ushtarake, të cilat Pheniani i ka kritikuar ashpër si "agresive dhe provokuese". Të enjten Koreja e Veriut lëshoi një raketë me rreze të gjatë rreth orës 07:40 sipas kohës lokale. Kjo e ka shtyrë qeverinë japoneze që të lëshojë një alarm të rrallë

emergjence të enjten në mëngjes për banorët në disa nga rajonet e saj veriore, duke u kërkuar atyre të qëndrojnë brenda. Tokio fillimisht tha se raketa kishte fluturuar mbi Japoni, por ministri i Mbrojtjes, Yasukazu Hamada, deklaroi më vonë se ajo "nuk kapërceu arkipelagun japonez, por u zhduk mbi Detin e Japonisë". ShBA-ja tha se lëshimi i kësaj raketë tregoi kërcënimin që programi raketor i Koresë së Veriut paraqet për fqinjët, paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. "Angazhimet tona për mbrojtjen e Republikës së Koresë dhe Japonisë mbeten të hekurta", tha një zëdhënës i Departamentit të Shtetit. Koreja e Veriut, më 28 tetor, ka lëshuar drejt detit dy raketa balistike me rreze të mesme veprimi. Ky ishte testimi i parë i armëve balistike që Veriu ka kryer në dy javët e fundit, teksa ushtria amerikane ka paralajmëruar se përdorimi i mundshëm i armëve bërthamore nga Pheniani do të "rezultonte në fundin e regjimit" të këtij shteti. Që nga shtatori i vitit të kaluar, Koreja e Veriut ka kryer një sërë testimesh, teksa ka thënë se po teston sistemet e armëve bërthamore që janë ta dizajnuara për të sulmuar caqe në Korenë e Jugut dhe në ShBA.

Limaj afër PDK-së, pi çaj me Nurën dhe Lushtakun

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, është takuar të enjten me ish-bashkëpartiakët, kryetarin e komunës së Skenderajt,

Fadil Nura dhe nënkryetarin Sami Lushtaku. “Një pasdite, çaj me miq!”, ka shkruar Nura në “Facebook”.

Ditët e fundit brenda PDK-së ka pasur zëra që Limaj të

rikthehet në këtë subjekt politik. Sami Lushtaku, nënkryetar i komunës së Skenderajt dhe Hajdar Beqa, deputet i Kuvendit të Kosovës, kanë thënë se e mirëpresin Limajn në PDK.



IPK-ja rekomandon suspendimin e drejtorit të policisë në veri

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Inspektorati Policor i Kosovës njoftoi se i ka rekomanduar Policisë së Kosovës suspendimin e drejtorit rajonal të Mitrovicës së Veriut, Nenad Gjuriq, i cili më 2 nëntor deklaroi se nuk do ta zbatojë vendimin e Qeverisë së Kosovës për targa. “Drejtori rajonal i Policisë së Kosovës në Mitrovicë të Veriut dyshohet se ka kryer veprat penale ‘Sabotim’ dhe ‘Thirrja për rezistencë’ të parapara në Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Krahas hetimit penal, do të shikohet edhe përgjegjësia administrative”, thuhet në njoftimin e Inspektoratit Policor të Kosovës.

Më 2 nëntor Gjuriqi tha se policët në veri nuk do ta zbatojë vendimin e qeverisë për shpërndarjen e fletëve qortuese për shoferët që kanë makina me targa të lëshuara nga Serbia. “Ne nuk mund ta zbatojmë atë vendim sepse ai është politik dhe i drejtuar kryesisht kundër komunitetit serb, të cilit i përkasim ne”, tha Gjuriqi dhe shtoi se “patrolla të njëjve të trafikut nga Prishtina janë dërguar në veri për të ushtruar presion”.



Këtë vendim Gjuriqi e kumtoi pas takimit me përfaqësuesit e Listës Serbe - partisë kryesore të serbëve në Kosovë dhe katër kryetarëve të komunave në veri, të banuara me shumicë serbe (Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok).

Gjuriqi tha se me këtë vendim paraprakisht është informuar edhe Drejtoria e Përgjithshme në Prishtinë si dhe të gjithë aktorët ndërkombëtarë.

Nenad Gjuriq në qershor të vitit 2013 ishte emëruar komandant rajonal i policisë në veri. Emërimi i tij erdhi pasi Kosova dhe Serbia arritën marrëveshjen e parë për normalizimin e raporteve në dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian.

Në pikën 9 të marrëveshjes thuhej se komandanti rajonal në katër komunat me shumicë serbe emërohet nga Ministria e

Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës.

Ndryshe, që nga 1 nëntori autoritetet në Kosovë kanë thënë se qytetarëve që kanë makina me targa ilegale (KM) do të japin fleta qortuese. Kjo është faza e parë e planit prej tri etapash, që Qeveria e Kosovës ka thënë se do të zbatojë nga 1 nëntori deri më 21 prill të vitit 2023 sa i përket reregjistrimit të makinave në targa RKS

(Republika e Kosovës).

Faza e dytë parasheh gjobë prej 150 eurosh për shoferët që kanë makina me targa serbe, ndërkaq në fazën e tretë do të përdoren targa provuese. Pas 21 prillit, sipas qeverisë, nuk do të lejohet qarkullimi i makinave që nuk kanë targa RKS.

Në katër komunat në veri të Kosovës, të banuara me shumicë serbe (Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok) vlerësohet se janë deri në 10 000 automjete me targa ilegale serbe. Këto targa i lëshon Serbia dhe bartin akronime serbe të qyteteve të Kosovës, si: KM, GL, PR, UR e të tjera.

Në javët e fundit janë shtuar incidentet në veri, që kanë pasur në cak kryesisht serbët që kanë reregjistruar makinat e tyre në RKS.

Vendimi për reregjistrimin e makinave fillimisht ishte paraparë të hynte në fuqi më 1 gusht, por u shty për një muaj për shkak se serbët lokalë ngritën barrkada në shenjë pakënaqësie ndaj këtij vendimi. Pak para se të skadonte afati për reregjistrim më 31 tetor, Qeveria e Kosovës njoftoi për planin e saj me tri faza për targa.

Haradinaj, letër Kurtit: Pranojeni kërkesën e ShBA-së për shtyrjen e vendimit për targa



EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, i ka shkruar letër kryeministrit Albin Kurti në lidhje me vendimin e fundit për targa ilegale serbe.

Haradinaj në këtë letër ka kërkuar nga Kurti që me urgjencë të pranojë kërkesën e ShBA-së për shtyrjen e zbatimit të vendimit për targa ilegale në afatin e kërkuar dhe t'i ndërprisë veprimet që ka marrë deri më tani për zbatimin e vendimit në fjalë. “Me shqetësim po e përcjell situatën e sigurisë në veri të vendit pas

vendimit tuaj të fundit për targa. Askush, as brenda Kosovës e as partnerët tanë ndërkombëtarë, nuk e kontestojnë drejtësinë e Kosovës për ta zbatuar ligjin në mbarë territorin e vendit, por momenti aktual është i ndjeshëm dhe kërkon maturi e gjakftohtësi, në mënyrë që të mos rrezikohet procesi drejt marrëveshjes finale në mes të Kosovës dhe Serbisë. Prandaj, ju kërkoj që me urgjencë ta pranoni kërkesën e Amerikës për shtyrjen e zbatimit të vendimit për targa ilegale në afatin e kërkuar dhe t'i ndërprisni veprimet që keni marrë deri tani për zbatimin e vendimit në fjalë”, ka shkruar

Haradinaj në letër letër.

Ish-kryeministri Haradinaj, gjithashtu, ka kërkuar që deri në marrëveshjen finale të mos ndërmerret asnjë veprim që e rrezikon sigurinë e vendit në cilëndo pjesë të tij, pa koordinim me Shtetet e Bashkuara. “Ju inkurajoj që ta kërkonin ndihmën e Këshilltarit Nacional për Siguri të presidentit Biden, z. Jake Sullivan, për t'i qartësuar dhe saktësuar veprimet që shtensionojnë situatën aktuale të sigurisë në rajon, deri në marrëveshjen finale në mes të Kosovës dhe Serbisë për njohje reciproke”, thuhet në letërën e Haradinajt drejtuar kryeministrit Albin Kurti.



Liderët e Ballkanit Perëndimor nënshkruajnë tri marrëveshje në kuadër të Procesit të Berlinit

Liderët e Kosovës, të Shqipërisë, të Bosnjë-Hercegovinës, të Malit të Zi, të Maqedonisë së Veriut dhe të Serbisë kanë nënshkruar tri marrëveshje për njohjen reciproke të letërnjoftimeve, të diplomave universitare dhe të kualifikimeve profesionale në kuadër të samitit të Procesit të Berlinit që po mbahet më 3 nëntor. Marrëveshjet e nënshkruara pas gati dy vjet negociatash, duhet fillimisht të ratifikohen para se të hyjnë në fuqi, ka njoftuar Qeveria e Kosovës. Marrëveshja për njohjen reciproke të letërnjoftimeve mundëson lëvizjen e lirë, pa viza, edhe në të mes Kosovës dhe Bosnjë-Hercegovinës

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Pas gati dy vjet të negociatave në mes të gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor, në mes të Kosovës, të Shqipërisë, të Bosnjë-Hercegovinës, të Maqedonisë së Veriut, të Malit të Zi dhe të Serbisë, Republika e Kosovës të enjten ka nënshkruar tri marrëveshje në kuadër të Procesit të Berlinit përmes të cilit jetësohet Tregu i Përbashkët Rajonal. Bazuar në rregullat e BE-së, marrëveshjet që janë

nënshkruar sot janë ato për lëvizjen e lirë me letërnjoftime; për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë dhe për njohjen e kualifikimeve profesionale të mjekëve, dentistëve dhe arkitektëve.

Përmes marrëveshjes për lëvizje të lirë me letërnjoftime, qytetarët e të gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor do të lëvizin lirshëm duke përdorur vetëm letërnjoftimin e njërës nga shtetet sipas legjislacionit në fuqi. Pas ratifikimit të kësaj marrëveshjeje, qytetarët e Kosovës dhe të Bosnjë-Hercegovinës më në fund do të

lëvizin lirshëm vetëm me letërnjoftime, duke sjell Prishtinën dhe Sarajevën afër qytetarëve të dy shteteve tona. Me marrëveshjen për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë diplomat e institucioneve publike të arsimit të lartë të gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor do të njihen me procedura të thjeshtësuara dhe falas, duke hequr një pengesë kyçe për mobilitetin e studentëve, akademikëve dhe fuqisë punëtore brenda rajonit. Me marrëveshjen për njohjen e kualifikimeve profesionale bëhet e mundur që profesionet e mjekëve, dentistëve dhe arkitektëve të ushtrohen lirshëm në secilin nga gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor. E bazuar në direktivën e BE-së 2005/36/EC për njohjen e kualifikimeve profesionale, kjo marrëveshje u mundëson qytetarëve që në shtetin pritës të ushtrojnë të njëjtin profesion për të cilin janë kualifikuar në shtetin amë dhe ta realizojnë këtë në kushte jo më pak të favorshme sesa qytetarët e shtetit pritës. Republika e Kosovës ka njoftuar

se është e angazhuar për bashkëpunim rajonal dhe do të shtyjë përpara marrëveshje të reja në kuadër të Tregut të Përbashkët Rajonal, të cilat jetësojnë liritë themelore dhe heqin pengesat e barrierat për zhvillimin e potencialit të qytetarëve të Ballkanit Perëndimor.

Scholz: Normalizimi në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të përshpejtohet

Nikoqiri i këtij samiti, kancelari gjerman Olaf Scholz, tha se nënshkrimi i tri marrëveshjeve të enjten është një hap i rëndësishëm drejt anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian. "Sot jemi të bindur se procesi i Berlinit jo vetëm që do të ndihmojë për shfrytëzimin e potencialit të plotë të bashkëpunimit rajonal, por do ta përshpejtojë anëtarësimin në BE të të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor", tha Scholz gjatë fjalimit hapës në këtë samit, i cili ka mbledhur

liderë të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe ata të BE-së. Ai shtoi se realizimi i dëshirës së këtyre vendeve për të hyrë në BE "është në interesin tonë", ndërsa gjithashtu kërkoi përshpejtimin e procesit të normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Është koha të tejkalohen konfliktet rajonale që kanë vazhduar shumë gjatë, konflikte që ju ndajnë dhe i mbajnë vendet tuaja prapa në rrugën evropiane. Procesi i normalizimit në mes të Kosovës dhe Serbisë në veçanti duhet të përshpejtohet, kështu që ejani ta bëjmë këtë", tha Scholz. Përveç bashkëpunimit rajonal, Scholz theksoi se "sfidat nga migrimi i parregullt, korrupsioni dhe krimi i organizuar janë çështje kyçe për të gjithë ne", ndërsa shtoi se vendet ballkanike duhet t'i harmonizojnë politikatat e vizave me BE-në. Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, e vuri theksin te mbështetja për energji elektrike që Bashkimi Evropian ka ndarë për vendet e Ballkanit Perëndimor. "Jemi këtu

Osmani: Marrëveshjet e arritura në kuadër të Procesit të Berlinit, përafrim me BE-në



PRISHTINË, 3 NËNTOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka mirëpritur marrëveshjet e arritura të enjten në Berlin, në kuadër të Procesit të Berlinit, duke theksuar rëndësinë e këtij procesi drejt forcimit të bashkëpunimit rajonal ndërmjet shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe krijimit të Tregut të Përbashkët Rajonal. Presidentja Osmani ka potencuar se marrëveshjet për lëvizjen e lirë me karta identiteti për shtetasit e rajonit, njohja e diplomave universitare dhe njohja e kualifikimeve profesionale të mjekëve, dentistëve dhe arkitektëve, do të kontribuojnë në forcimin e bashkëpunimit rajonal

dhe në heqjen e barrierave administrative në mes të shteteve të Ballkanit Perëndimor, duke u afruar edhe më shumë vlerat dhe praktikatat evropiane të bashkëpunimit. Në këtë drejtim, presidentja Osmani ka falënderuar kancelarin federal të Gjermanisë, Olaf Scholz, si dhe udhëheqësit e Bashkimit Evropian, për përkushtimin e tyre ndaj integritetit evropian të Kosovës dhe Ballkanit Perëndimor, duke theksuar se Kosova do të vazhdojë të mbetet palë plotësisht e përkushtuar ndaj Procesit të Berlinit dhe bashkëpunimit rajonal në frymën e barabarësisë.



për ta thelluar integrimin ekonomik duke nisur me energjinë. Pakoja për Mbështetjen Energjike prej një miliardësh për Ballkanin Perëndimor do të na ndihmojë ta formësojmë të ardhmen tonë të përbashkët në energji", ka shkruar Von der Leyen në "Twitter".

Von der Leyen, gjatë vizitës në Kosovë më 27 tetor, kishte bërë me dije se BE-ja pritet të ndajë 75 milionë euro ndihmë të menjëhershme për Kosovën për përbashkëtimin e krizës energjetike. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, pas nënshkrimit të marrëveshjes, në një postim në "Twitter", theksoi rëndësinë e ndihmave financiare për mbulimin e kostove të energjisë.

"Gazi i lirë i Rusisë është i kushtueshëm për sigurinë e Evropës dhe jetën e njerëzve në Ukrainë. Neve na duhen të dyja: energji e gjelbër dhe e qëndrueshme, por tranzicioni duhet të jetë i drejtë dhe kostot duhet të ndahen. Nevojitet solidaritet dhe mbështetje financiare", ka shkruar Kurti.

Procesi i Berlinit ka nisur në vitin 2014 me iniciativën e kancelares së atëhershme gjermane Angela Merkel. Ndër qëllimet kryesore të këtij procesi janë: përmirësimi i bashkëpunimit rajonal dhe integrimi evropian i rajonit të Ballkanit Perëndimor. Procesi fokusohet në lëvizjen e lirë të njerëzve, shërbimeve, mallrave dhe kapitalit.

Takimet në margjina të Procesit të Berlinit

Para fillimit të samitit, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, u takua me përfaqësuesin e lartë të BE-së për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë, Josep Borrell, dhe përfaqësuesin e Posaçëm të Bashkimit Evropian për Dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajčak.

Zyra e kryeministrit njoftoi se ata biseduan për marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe elementet e kornizës së marrëveshjes për normalizimin e plotë të raporteve me njohjen

reciproke në qendër, si dhe për vendimin e fundit të qeverisë për targarat ilegale. "Në lidhje me zbatimin e vendimit për targarat ilegale, kryeministri Kurti tha se nëpërmjet sekuencimit në tri etapa dhe shkallë, Qeveria e Republikës së Kosovës ka treguar vendosmërinë për sundimin e ligjit dhe përkushtimin për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në vend. Ai bëri thirrje që dëmtimi dhe djegia e veturave me targa RKS në veri të vendit të dënohet nga të gjithë", thuhet në njoftim.

Ndërsa Borrelli ka shkruar në "Twitter" se gjatë këtij takimi me Kurtin u diskutua për situatën në veri të Kosovës dhe ka bërë thirrje të respektohen marrëveshjet e arritura në dialog. "Diskutuam për situatën në veri të Kosovës. Veprimet përçarëse, si djegia e veturave, janë të papranueshme. Marrëveshjet e dialogut duhet të respektohen. Ftojme të gjithë të jenë të përbajtur në veprime. Ne, gjithashtu, diskutuam për normalizimin", ka shkruar Borrelli.

Sulmohet stacioni policor kufitar në Zubin Potok

MITROVICË, 3 NËNTOR - Policia e Kosovës ka njoftuar për të shtëna me armë zjarri në stacionin policor kufitar në fshatin Jasenovik të Zubin-Potokut. Sipas njoftimit, sulmi ka ndodhur të mërkurën në mbrëmje dhe nga zyrtarët policorë janë dëgjuar dy të shtëna armësh radhazi. "Policia e Kosovës, në këtë rast zyrtarët policorë të cilët kanë qenë në detyrë në stacionin policor kufitar në Jasenovik, kanë informuar se më 2 nëntor gjatë natës kanë dëgjuar të shtëna armësh (dy të shtëna radhazi), përderisa ishin në realizim të detyrave të tyre në vendin e quajtur Jabuke.

Njësia relevante policore ka gjetur një predhë plumbi e cila kishte goditur rrethojën e objektit të stacionit policor për mbikëqyrje kufitare në Jasenovik. Lidhur me rastin Drejtoria Kundër Terrorizmit po kryen hetime mbi dyshimet për kryerjen e veprave terroriste", ka njoftuar Policia e Kosovës, duke shtuar se me njësitet policore do të vazhdojnë angazhimet për realizimin e detyrave dhe autorizimeve ligjore për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, parandalimin e krimit dhe kontrabandës si dhe shërbimin ndaj vendit dhe të gjithë qytetarëve pa dallime.



Komuna e Prizrenit nënshkruan memorandum me UN Women

PRIZREN, 3 NËNTOR - Komuna e Prizrenit ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me Entitetin e Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizim të Grave (UN Women). Aktivitetet në kuadër të këtij memorandum do të realizohen në kuadër të Projektit të UN Women

"Financimi Transformativ për Barazi Gjinore në Ballkanin Perëndimor (2020-2024)" financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim. Të gjitha aktivitetet do të realizohen në përputhje me rregulloret, rregullat dhe direktivat e UN Women.

Nura viziton punimet në objektet banesore në Skenderaj

SKENDERAJ, 3 NËNTOR - Me intensitet të shtuar janë duke u zhvilluar punimet në kuadër të projektit të qeverisjes Nura për fasadimin e objekteve banesore përgjatë sheshit "Adem Jashari" në qytetin e Skenderajt. Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, ka vizituar të enjten punimet që po zhvillohen në objektet banesore, ku njëjës

aktualisht është duke u vendosur çatia, kurse tjetra po fasadohet sipas modelit për të cilin ishin përcaktuar të gjithë banorët para se të fillojë procesi. Sipas kryetarit Nura, fasadimi është një nga punët e mira për banorët e objekteve banesore në sheshin "Adem Jashari", të cilat po transformohen nga dita në ditë dhe po marrin pamje të re.



Bulliqi viziton hapësirat e rregulluara të "Parku i Pishave" dhe "Parku Manchester"



PODUJEVË, 3 NËNTOR - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi dhe drejtori i Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, Vigan Salihu, kanë vizituar "Parkun e Paqes" dhe "Parkun Manchester", ku janë duke u zhvilluar punime nga komuna. Në këto parqe janë pastruar hapësirat, ndërtuar

kënde të lojërave për fëmijë, hapësira të rekreacionit si shahu e tavolina të ping pongut, si dhe gjatë kësaj kohe po ndërtohet kinemaja e hapur (amfiteatri). Në këto parqe, gjithashtu, janë vendosur pushimore, shporta të mbeturinave, çezma për ujë të pijshëm.

Kryetari Bulliqi gjatë vizitës tha se është shumë i kënaqur me punimet dhe pamjet që kanë marrë këto hapësira. "Tash nevojitet mirëmbajtje e përkujdesje nga secili qytetar. Kërkoj nga të gjithë qytetarët që i shfrytëzojnë këto hapësira të kujdesen për to", ka thënë Bulliqi.

27 vjet pa plakun e urtë Anton Çetta

PRISHINË, 3 NËNTOR - Të enjten janë bërë 27 vjet qëkur është ndarë nga jeta plakun e urtë Anton Çetta. Profesor Çetta do të mbahet mend si figurë me kontribut shumëdimensional

në shoqërinë tonë, emri i të cilit mbetet i pazëvendësueshëm në historinë e shekullit XX të Kosovës. Angazhimi dhe veprimtaria e tij u bënë shkas për unitet

mbarëshqiptar, duke i dhënë fund epokës së gjakmarrjes, vëllavrasjes dhe ngatërresave në shoqërinë tonë, për t'u mbledhur rreth një synimi madhor, që ishte çlirimi i vendit.



PRESIDENTJA E KOSOVËS, VJOSA OSMANI, ËSHTË OPERUAR PËR HEQJEN E TËMTHIT NË SPITALIN PRIVAT "ALOKA"

Presidentja injoroi spitalin publik, i nënçmoi edhe mjekët

Më 2 nëntor presidentja e vendit, Vjosa Osmani, i është nënshtruar një intervenimi kirurgjik (heqja e tëmthit) në spitalin privat "Aloka". Por ky veprim i presidentes për ta zgjedhur spitalin privat për operim dhe jo atë publik ka ngjallur reagime të shumta nga shoqëria civile dhe profesionistët shëndetësorë

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Opinionisti Imer Mushkolaj ka komentuar intervenimin kirurgjik të presidentes Vjosa Osmani në një spital privat në Kosovë. Ai ka shkruar në "Facebook" se Osmani më 19 tetor vizitoi Klinikën e Onkologjisë në QKUK, ku tha se shëndetësia duhet të jetë prioritet në Kosovë, ndërkaq operacionin e kreu në klinikë private. "Ajo falënderoi edhe mjekët për punën që bëjnë. Dy javë më vonë Vjosa Osmani injoroi spitalin publik, i nënçmoi këta mjekë dhe kreu një operacion të thjeshtë në klinikë private. Hipokrizia ka emër", ka shkruar Mushkolaj.

Zyra e Presidentes së Kosovës ka njoftuar se më 2 nëntor, pas rekomandimit nga mjekët specialistë, presidentja Vjosa Osmani i është nënshtruar një

intervenimi të lehtë kirurgjik (heqja e tëmthit), i cili është realizuar me sukses.

Edhe gazetari Berat Buzhala ka komentuar operimin e Osmanit në spital privat. Ai ka thënë se intervenimi kirurgjik i saj në spitalin privat "Aloka" është ofendim për qindra mjekë që punojnë në QKUK. "Presidentes i urojme shërim të shpejtë. Intervenimi kirurgjik i saj në spitalin privat 'Aloka' është ofendim për qindra mjekë që punojnë në QKUK dhe është tallje me mijëra banorë të tjerë të vendit tonë që shërbimet i marrin në sektorin publik", ka shkruar Buzhala në "Facebook". Buzhala ka theksuar se "nëse presidentja nuk i beson spitalit të shtetit, çka duhet me thanë të tjerët? Shto këtu faktin që heqja e tëmthit është një ndërhyrje e thjeshtë kirurgjike. (Thaçi u pat operuar në kohën e pandemisë në QKUK.)"



Edhe analisti dhe gazetari Ilir Mirena ka thënë se Vjosa Osmani për një ndërhyrje të thjeshtë qenka operuar në një klinikë private. "Nuk i ka besuar sektorit publik të shëndetësisë", ka shkruar Mirena në "Facebook".

Ndërkaq kirurgët e Klinikës së Kirurgjisë Abdominale të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK) kanë reaguar ndaj operimit të presidentes në një spital privat. Në reagimin e tyre është thënë se Osmani ka injoruar dhe nënçmuar institucionin publik, pavarësisht se intervenime të tilla kirurgjike kryhen edhe në QKUK që nga nëntori i vitit 1999. "Duke u bazuar në situatën aktuale, Kolegjiumi i Kirurgëve

të Kosovës reagon ndaj anashkalimit të presidentes së Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, që i ka bërë këtij institucioni duke mos kërkuar trajtim shëndetësor jashtë ShSKUK-së. Në bazë të informatave nga mediet, presidentja i është nënshtruar një procedure e cila në Klinikën e Kirurgjisë Abdominale është rutinë ditore që nga 12 nëntori 1999, me përqindje të suksesit 99,9 për qind. Injorimi dhe nënçmimi që presidentja i ka bërë Kolegjiumit të Kirurgëve, në veçanti institucionit tonë, është e papranueshme për të gjithë. Duke i dëshiruar shëndet të plotë presidentes znj. Vjosa Osmani, urojmë që raste të tilla të mos përsëritën kur institucionet

zyrtare anashkalojnë institucionet shëndetësore publike", thuhet në reagimin e Kolegjiumit të Kirurgëve.

Por jo njëjtë si Osmani kishte vepruar Hashim Thaçi sa ishte president. Ai në prill të vitit 2020 i është nënshtruar një intervenimi kirurgjik endourologjik në Klinikën e Urologjisë në Shërbimin Spitalor Klinik-Universitar të Kosovës. Lajmin e kishte bërë me dije në atë kohë Presidenca. "Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, sot pasdite i është nënshtruar një intervenimi kirurgjik endourologjik në Klinikën e Urologjisë në Shërbimin Spitalor Klinik-Universitar të Kosovës. Sipas personelit mjekësor, operacioni ka qenë i suksesshëm dhe presidenti është nën kujdesin e vazhdueshëm të personelit mjekësor profesional", shkruhej në njoftimin e Presidencës së Kosovës.

Në spitalet private në Kosovë operimi më i thjeshtë i tëmthit fillon nga 500 euro deri në 1900 euro, duke përfshirë edhe analizat që duhet të bëhen para operacionit që kushtojnë 200 deri në 300 euro. Ndërkaq në spitalin publik, ShSKUK, një operim i tillë kushton zero euro.

Reçica viziton shkollën shumetnike në Prizren: Komunitetet joshumicë i japin kuptim demokracisë

PRIZREN, 3 NËNTOR - Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Elmi Reçica, së bashku me kolegun e tij deputet, Enis Kervan, kryetarin e Prizrenit, Shaqir Totaj dhe kryesuesin e Komisionit Parlamentar për Stabilizim Asociim BE - Kosovë, Romeo Franz, kanë vizituar Shkollën Fillore "Mati Logoreci" në Prizren, shkollë kjo shumetnike në të cilën, përveç nxënësve shqiptarë, në gjuhët e tyre respektive mësojnë edhe nxënësit nga komuniteti rom, turk dhe ai boshnjak. "Pas shumë

kërkesave dhe insistimeve të komunitetit rom, të shoqatave të ndryshme të Prizrenit, me iniciativën time dhe kolegut Enis Kervan, me mbështetjen e fuqishme të kryetarit të komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, Kuvendi Komunal i Prizrenit njohu gjuhën rome si gjuhë në përdorim zyrtar në këtë komunë", ka thënë Reçica në vizitën që i bëri kësaj shkolle. Deputeti Reçica ka thënë se është ndjenjë jashtëzakonisht e mirë kur shohim shembuj të tillë të zhvillimit të mësimi. "Komunitetet joshumicë në



Kosovë janë vlerë e shtuar e shoqërisë kosovare. Komuna e Prizrenit është model në këtë drejtim. Shembuj të tillë i japin kuptim demokracisë dhe respektimit në praktikë të lirive dhe të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të drejtave të komuniteteve joshumicë në veçanti", ka theksuar Reçica.

Deputeti Reçica uron famullitarin Don Mikel Sopi

Deputeti i Kuvendit të Kosovës, Elmi Reçica, ka vizituar edhe Kishën Katolike "Engjëlli i Rojës"

në Ferizaj, me ç'rast ka uruar Don Mikel Sopi për marrjen e përgjegjësisë së famullitarit. "Në Kishën Katolike 'Engjëlli i Rojës' në Ferizaj, për t'i uruar Don Mikel Sopi përgjegjësinë e famullitarit, duke i dëshiruar shëndet dhe shumë suksese në rrugëtimin e tij", ka shkruar Reçica në "Facebook".



Mazreku vazhdon lobimin për anëtarësim në Byronë e Kartonit të Gjelbër

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), Sami Mazreku, së bashku me drejtorin Financiar të BKS-së, Valon Berisha, të enjten në Athinë kanë takuar Tassos Paginos, kryesues i Byrosë Greke të Sigurimeve, si dhe Elina Paspapropoulou, drejtore e Asociacionit të Sigurimeve në Greqi, ku me ta kanë biseduar rreth përkrahjes së Greqisë për anëtarësimin e

Kosovës në Byronë e Kartonit të Gjelbër.

Pas takimit Mazreku ka vlerësuar lart përkrahjen nga autoritetet greke dhe ka paralajmëruar se shumë shpejt Byroja Kosovare e Sigurimit do ta gjejë mundësinë për anëtarësimin e Kosovës në Byronë e Kartonit të Gjelbër.

Para pak ditësh, gjatë shënimit të 11-vjetorit të BKS-së,

presidentja dhe drejtoresha e Byrosë së Kartonit të Gjelbër kanë konfirmuar se në aspektin teknik BKS-ja tashmë i ka plotësuar të gjitha kriteret. Drejtori Mazreku është duke vazhduar takime të vazhdueshme me drejtues të Byrove për të marrë nga ta përkrahje për arritjen e qëllimit, pra anëtarësimin e Kosovës në Byronë e Kartonit të Gjelbër.



Banka e Shqipërisë në luftë me inflacionin, rrit sërish normën e interesit

TIRANË, 3 NËNTOR - Në Shqipëri Banka Qendrore ndërhyri sërish për të katërtin muaj radhazi, duke rritur për 0.5 pikë përqindje normën bazë të interesit, në përpjekje për t'iu kundërpërgjigjur një inflacioni gjithnjë e në rritje. Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës, norma bazë ngjitet në nivelin 2.75 për qind.

Fillimisht Banka e preku atë në muajin mars kur inflacioni dha shenjat e para të tendencës në rritje, duke regjistruar ndërhyrjen e parë pas trembëdhjetë vjetësh të një politike stimuluese që e zbriti normën e interesit në minimumin e saj historik prej 0.5-përqindësh.

Banka e Shqipërisë ka theksuar se presionet inflacioniste "mbeten rreziku kryesor mbi rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit".

Në tremujorin e tretë inflacioni i çmimeve të konsumit shënoi një tjetër rritje, duke kapur vlerën mesatare prej 7.9-përqindësh, pasi në muajin gusht dhe shtator arriti, sipas Instat-it, kuotat 8 dhe 8.1 për qind.

Sipas Këshillit Mbikëqyrës, "pasoja e goditjes së ofertës të huaj në ekonominë shqiptare po bëhen gjithnjë e më të dukshme. Në veçanti, analiza e informacionit të disponuar sugjeron se presionet inflacioniste po vijnë në rritje dhe baza e tyre shfaqet në zgjerim".

Por sipas vlerësimeve të Bankës, rritje e çmimeve është vënë re edhe në produktet lokale, pjesë e



shportës së konsumit. "Rritja e inflacionit pasqyroi, në masën më të madhe, rritjen e çmimit të ushqimeve, të naftës dhe të kostove të transportit. Këta grup-artikuj gjeneruan rreth 8 për qind të inflacionit total në tremujorin e tretë. Megjithatë, rritja e çmimeve ka filluar të jetë e pranishme në pjesën më të madhe të shportës, përfshirë edhe ata artikuj pjesa më e madhe e vlerës së shtuar të të cilëve krijohet në vend. Kjo ecuri sugjeron rritjen e njëkohshme të

bazës dhe të intensitetit të presioneve inflacioniste", shpjegoi guvernatori i Bankës, Gent Sejko, pas mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës.

Banka Qendrore pret që inflacioni të mbetet i lartë deri në fund të vitit, por të reduktohet progresivisht gjatë vitit 2023 dhe të kthehet në objektiv (3 për qind) në tremujorin e dytë të vitit 2024. Për pasojë, Banka pritet të vijojë edhe me ndërhyrje të tjera në muajt që pasojnë. Një politikë e tillë agresive u sugjerua më

herët dhe nga misioni i Fondit Monetar Ndërkombëtar. "Duke qenë se rreziqet për perspektivën e inflacionit janë në kahun e sipërm, shtrëngimi monetar duhet të sjellë para në kohë dhe rritje të mëtejshme të normës të interesit janë të nevojshme. Veprimet e vendosura tani do të ndihmojnë për të parandaluar një spirale pagë-çmim, do ta ulë rrezikun që pritshmëritë inflacioniste të ç'ankorohen dhe do t'i shmangë vonesat e tepërta në

shtrëngimin monetar, çka mund të bëjë të nevojshme më vonë rritje mjaft më të mëdha të normave të interesit. Banka e Shqipërisë duhet të jetë e përgatitur që ta rrisë normën e interesit mbi nivelin e vlerësuar të interesit neutral në rast se presionet inflacioniste nuk ulen", rekomandoi FMN-ja tri javë më parë, duka parashikuar se "norma bazë e interesit do të rritet në 3-3.5 për qind në vitin 2022 dhe 4-4.5 për qind në vitin 2023".

Gjermania mbush depozitat e gazit 99.19 për qind

BERLIN, 3 NËNTOR - Objektet gjermane të depozitave të gazit tani janë plot 99.19 për qind, sipas të dhënave më të fundit paraprake nga operatorët evropianë të magazinimit të gazit.

Ambientet e magazinimit po kompensojnë luhatjet e konsumit të gazit.

Zakonisht ato mbushen mirë kur sezoni i ngrohjes fillon në

vjeshtë. Nivelet e tyre më pas bien deri në pranverë. Në Gjermani ka rreth 25 operatorë magazinimi me rreth 40 depo nëntokësore të gazit.

Qeveria gjermane është përpjekur të sigurojë që hapësirat e depozitimit të gazit të jenë pothuajse plot kur të fillojë moti më i ftohtë. Këtë vit synimi është që vendi të

përgatitet më mirë për humbjen e mundshme të plotë të furnizimeve ruse në dimër. Presidenti i Rregullatorit të Energjisë të Gjermanisë, Agjencia Federale e Rrjetit, Klaus Muller tha se, pavarësisht prej arritjeve historike në ruajtje, është e rëndësishme të jesh shumë i kujdesshëm me konsumim të gazit.



Heinrich Schliemann - aventurier, hajdut, hero!?

Nga: Robin Lane FOX
The Financial Times

Të joshin dhe të magjepsin ndryshimet e karrierës në mesomoshë. Komediani bëhet lider politik dhe kolumnisti zhbirues i Financial Times-it bëhet mësues matematike. Dy ish-kryeministra tash do t'i kërkojnë rrugët e reja. Unë nuk ndryshoj në mesomoshë, ndaj më tërheqin të tjerët që e bëjnë ndryshimin. Herë pas here më kontaktojnë drejtorët e merrtur të kompanive, për të më njoftuar se po synojnë që të bëhen arkeologë. Sa mirë do të ishte, pyesin ata, ta zbulojnë atë entitet të pakapshëm – varrin e Lekës së Madh?

Para se t'i injorojmë, më kujtohet pararendësi i famshëm i tyre – Heinrich Schliemann. Deri në mesin e të tridhjetave, ishte biznesmen global – aktiv nga Rusia e deri në Kaliforni – por më pas u zhvendos në Paris për ta studiuar filologjinë, filozofinë dhe antikitetin. Energjia e tij ishte vërtet e mahnitshme, qoftë duke u ngjitur në male, duke kampuar, duke notuar apo duke shkruar – deri atëherë – dhjetë mijë letra. Nga viti 1870 e deri në 1890, i drejtoi gërmimet e vetëfinancuara në Turqi dhe në Greqi. Doli me rezultatet e famshme botërore.

Fillimisht i zbuloi shtresat e varrosura – prej kohësh të humbura – të Trojës së lashtë. Më pas u zhvendos në Mikenë të Greqisë, ku organizoi gërmimin e një rrethi varresh, ari i të cilave është ende shfaqja kryesore në muzeun arkeologjik të Athinës. Në vitet 1880 filloi të gërmonte në vendin e rëndësishëm grek të Orhomenusit, dhe më 1884 në lokacionin e Tirintit të famshëm për muret masive të ndërtuara me gurë. Në vitet 1887-88 ishte në Egjipt ku, në të vërtetë, një nga planet e tij ishte ta gjente varrin prej kohësh të humbur të Lekës.

Tani ai është në mendjen time. Këtë javë e dorëzova tekstin përfundimtar të librit tim për Homerin dhe për Iliadën e tij që do të botohet gjatë verës së ardhshme. E nisa që në izolimin e parë të pandemisë, duke i thënë vetes se me të do ta paguajë faturën time të haruar të energjisë elektrike. Është rritur dhe thëlluar përtej pritshmërive të mia, por gjithashtu edhe fatura e energjisë elektrike. Teksa shkruaja për Homerin, u hodha në çështjen e Schliemannit dhe të reputacionit të tij. Ai është shembulli klasik i asaj që mund të arrijë një i jashtëm në karrierën e vonshme. Vendet e Trojës, Mikenës e kështu me radhë, nuk ishin zbulime të tija, por shpërtheu në një fushë që ecte ngadalë dhe e transformoi atë me gërmime të vrullshme dhe madhështore.

Në maj, me ftesë nga pasardhësit e tij të gjallë, isha në Berlin për hapjen e një ekspozite të madhe: Botët e Schliemannit: Jeta, zbulimet, Miti i tij. Deri në janar ishte e hapur në Muzeun Neues dhe në Galerinë



James Simon. Ishte dyqindvjetori i lindjes së tij dhe Matthias Wemhoff dhe ekipi i tij i kuratorëve kanë bërë punë të jashtëzakonshme për ta shënuar këtë përvjetor. Madje, shumë objekte të vogla ari të gërmimeve të tij në Mikenë, i kanë marrë hua nga Athina. Ekspozimi i tyre më shpiu në nivelin e gjerë të Schliemannit dhe në historinë e jetës së tij.

Më shumë se 700 eksponate e kanë ndjekur atë gjatë 68 vjetëve të tij, që nga koha si tregtar në Rusi dhe në Kaliforni, duke u shitur ar edhe Rothschildsve, deri në jetën e kaluar në Japoninë e porsahapur dhe në Paris, e përfundimisht në Athinë. Një heroinë paralele i shfaqet gjatë rrugës – gruaja e tij e dytë Sofia, grekja e re me të cilën ai u martua kur ajo ishte vetëm 17 vjeçe. Ajo më së miri mbahet mend për fotot e tij me të, teksa i mbante ato që ai i quajti, nga fantazia, xhevahiret e Helenës – objektet e gjetura nga ai në Trojë. Si e ve për rreth 40 vjet, ishte ajo që bëri shumë për ta mbajtur gjallë mitin dhe kujtesën e Schliemannit. Jeta jonë e përtejme varet nga të tjerët.

Në natën e hapjes së ekspozitës, i pashë nxënësit e shkollave të Berlinit që para publikut të entuziazmuar gjerman shfaqnin episode nga Lufta e Trojës. Në një vlerësim të balancuar mirë, Wemhoff na tha se si Schliemann u përkujtua pas vdekjes me një monument të madh në Varrezën e Parë të Athinës. Në mënyrën e Greqisë së lashtë, i përkushtohet heroit Schliemann, ndërsa basorelievet ilustronë jetën e tij si gërmues. Më habit se sa pak turistë në Athinë shkojnë për ta parë atë dhe se sa pak e vizitojnë rezidencën e tij pranë Sheshit Sintagma, të cilën e drejtonte Sofia. Schliemannit e quajti Iliou Melathron (Salla e Trojës). Është mirë e dekoruar dhe afresket e saj klasike dhe dyshemetë me mozaikë janë rezultat i shijes së Sofisë.

Ndjeva se publiku gjerman ishte në

anën e heroit Schliemann. Në studimet anglofone, reputacioni i tij është dërrmuar. Arkeologët profesionistë e shohin si vandal, gënjeshtar, trillues dhe hajdut. Përdori dinamit për të përshpejtuar gërmimet. Pa kërkuar leje nga sundimtarët osmanë në Turqi, i tërhoqi objektet që gjeti në Trojë; megjithatë, disa prej gjetjeve të tij të mëvonshme ia dha Athinës ku mendonte se ato përkisnin. Mbajti shënime shumë të dobëta për gërmimet e veta: megjithatë, ditarët e tij janë të detajuar dhe ia vlen të lexohen. Në Aleksandri, në vitet 1887-88, futi në dhe antikitetet në vendin që donte të gërmonte – për ta kërkuar varrin e Lekës. Më pas i "rigjeti" dhe pretendoi se ato e mbështetën kërkesën e tij për të marrë leje për të gërmuar më tej.

Në Trojë, Schliemann gaboji me atë që e quajti Thesari i Priamit dhe me datën e kësaj: ndoshta ato i grumbulloi nga gjetje të ndryshme. Vite më vonë, hajdutët e kohëve të fundit, pushtuesit rusë, nga Berlina i kohës së luftës morën shumëçka nga ky thesar dhe i çuan ato në Rusi. Më i bukuri nga gjerdanët e thesarit të artë është ende në Berlin, por pjesa tjetër, kam frikë, nuk do të kthehet së shpejti.

Duke shkruar për Homerin, e pash veten se si po zbrapsem nga Schliemannit, por edhe duke e admiruar atë. Një nga zbulimet e tij më të mëdha ishte arkeologu Wilhelm Dörpfeld, i cili i udhëhoqi gërmimet e Tirint, dhe që pas vdekjes së Schliemannit i dha shumë më tepër kuptim Trojës. Megjithatë, Schliemann fillimisht e kuptoi se kishte datuar shumë vonë nivelet e hershme të Trojës. Ai gjithashtu nisi ta kuptojë rëndësinë thelbësore të qeramikës së lashtë, për t'i datuar shtresat e shumta në një vend. Ai nuk ishte fanatik kokëfortë, siç disa kanë pretenduar.

Sidoqoftë, autobiografitë e tij janë plot me "kujtime" të rreme. Një herë e përshkruan zjarrin e madh të San Franciskos të vitit 1851, por

kurrë nuk ishte dëshmitar i kësaj: përshkrimi i tij është shumë i gjallë, i shkruar si gazetar nga raportet bashkëkohore. Sipas standardeve moderne shkencore, gërmoi shumë shpejt, jo gjithmonë në vendin e duhur, siç dëshmon puna në një pjesë të tumës së lashtë në Trojë. Megjithatë, pa sulmin e tij të egër, ne mund të merreshim ende me nivelet e sipërme të lokacionit, pa pasur asnjë ide se sa thellë shkonin shtresat e qyteteve të mëparshme. Kur Schliemann gërmoi, nuk kishte shkencë të pranuar të stratigrafisë për të kalibruar ndryshimet e nivelit në një vend të lashtë. Gërmimi kishte ende shumë të përbashkëta me gërryerjen dhe minierat.

Gabimet e tij shpesh nxiteshin nga një forcë të cilën edhe unë e pranoj: dashuria për poemat epike të Homerit dhe një obsesion për atë që fshihej prapa tyre. Pasi hoqi dorë nga karriera e biznesit, Schliemann fillimisht eksploroj Itakën, ishullin e origjinës së Odisesë. Në Trojë u shty nga keqleximi literal i Iliadës: poemën e Homerit donte ta vërtetonte si historikisht të saktë. Teksa Homerit e gjeti mbretërinë e Agamemnonit në Mikenë, ishte e kuptueshme që Schliemann donte të gërmonte edhe atje dhe se më pas besonte se kishte zbuluar maskën e vdekjes së Agamemnonit të Homerit.

Në vitet 1870, nuk ishte i vetmi fundamentalist historik për poemat e Homerit, por dashuria e tij për to ishte e fortë. Fëmijëve ua vuri emrat Andromaka dhe Agamemnon. Recitoi 100 rreshta të Iliadës përmendësh kur e çoi Agamemnonin në pagëzim dhe e mbajti një kopje të Homerit në ballin e Andromakës, përpara se ajo të pagëzohej.

A i justifikon dashuria e tillë ndaj Homerit, trillimet dhe gabimet në atë që duhet të ishte punë shkencore? Sigurisht, Schliemann nuk do të fitonte kurrë ndonjë punë moderne akademike, por gjithash-

tu kishte talent që pak arkeologë akademikë mund barazohen me të: ishte gjuhëtar i mrekullueshëm. Në moshën 24-vjeçare fliste gjermanisht, frëngjisht, holandisht, italisht, anglisht, spanjisht, portugalisht dhe rusisht. Së shpejti i shtohet polonishtja dhe suedishtja, pastaj danishtja dhe slovenishtja dhe në fund latinishtja dhe greqishtja moderne dhe e lashtë.

I mësoi ato me një metodë të qëllimshme: recitoi një pjesë të gjatë në një gjuhë dhe e mësoi atë përmendësh, para se të mësonte fjalorin dhe gramatikën e saj. Më pas i kombinoi me mësimet e përditshme nga një mësues i gjuhës. Kjo metodë ishte para dashurisë së tij për Homerin. Atij i kujtohej, me siguri me të drejtë, se si në adoleshencë dëgjoji një mullixhi, një të dehur të refuzuar nga një shkollë e mirë gjermane, i cili i recitonte 100 vargje nga Odisesë së Homerit. Schliemann thotë se qau me tingullin ritmik dhe iu lut Zotit që ta mësonte greqishten e vjetër. Mësimi dhe recitimi gojor u bënë çelësat e tij gjuhësor.

Edhe këtë javë kam menduar për këtë. Kolegët e mi janë gati të fillojnë intervistimin e kujdesshëm të aplikantëve në Universitetin e Oksfordit, si dhe vlerësimin e punës së tyre të dorëzuar parapraakisht. Kur fillova të intervistoj aplikantët në vitin 1977, intervistat kryheshin në frëngjisht ose gjermanisht, nëse një kandidat aplikonte për ato lëndë. Tani pothuajse të gjithë ata që njohin një roman gjerman, e dinë atë vetëm nga një përkthim në anglisht. Sa i përket greqishtes klasike dhe latinishtes, njohuritë për kryeveprat e tyre kanë rënë që nga vitet 1970. Metoda e Schliemannit ende respektohet në Sorbonë. Shkollat angleze, që kalojnë nëpër ndonjë pjesë të një gjuhe, duhet të bëhen gati për ta zbatuar këtë. Schliemann e transformoi Trojën: ai gjithashtu mund t'i transformonte monoglotët britanikë. /Telegrafi/



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Kosova me shumë ndryshime në ndeshjet e nëntorit

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll do t'i zhvillojë dy ndeshje miqësore në muajin nëntor, disa ditë para fillimit të Kampionatit Botëror. Grumbullimi i "dardanëve" do të fillojë më 14 nëntor, ndërsa sfidat do të jenë ndaj Armenisë dhe Ishujve Faroe. Të dyja sfidat do të zhvillohen në stadiumin "Fadil Vokrri" në kryeqytet. E para ndaj Armenisë luhet më 16 nëntor, e dyta me Ishujt Faroe tri ditë më vonë. Por në këtë grumbullim pritet të ketë shumë risi në listën e përzgjedhës të Kosovës, Alain Giresse. Trajneri francez nga e hëna deri në të mërkurën ka telefonuar yjet kryesorë të Kosovës për t'i treguar se nuk do t'i grumbullojë për këto dy miqësore. "Telegrafi" raporton se Giresse ka telefonuar dhjetëra futbollistë që kanë bartur barrën kryesore në ndeshjet e fundit për t'i konfirmuar se do t'i lë pushim për këto dy sfida, pasi qëllimi i tij është t'u japë rast futbollistëve që kanë

luajtur më pak dhe do të ketë emra të rinj në listë. Kapiteni i "dardanëve", Amir Rrahmani, nuk do të grumbullohet shkak i lëndimit, derisa bashkë me të nuk pritet t'i bashkohen Kosovës në këtë grumbullim as futbollistët kryesorë si Muriqi, Hadergjonaj, Vojvoda, Rashani, Celina, Rashica, Dresheviq, Aliti, Bytyqi, Muslija, Zeneli e të tjerë. Në këtë grumbullim do të ketë disa emra të rinj te Përfaqësuesja e Kosovës, futbollistë që nuk janë ftuar kohën e fundit apo emra që do t'u bashkohen për herë të parë "dardanëve". Pritet që nga Giresse të ketë edhe ftesa për lojtarët nga Superliga e Kosovës ku së fundmi ishin grumbulluar Lumbardh Dellova, Lindon Emërllahu dhe Ilir Krasniqi. Kësaj treshe pritet t'i bashkohet edhe Armend Thaqi dhe futbollistë të tjerë nga skuadrat e Superligës së Kosovës. Gjithashtu, në listë pritet të jenë edhe dy ish-



futbollistët e Ballkanit që tani po luajnë me plot sukses në Evropë, si Jetmir Topalli që po shkëlqen në Superligën e Turqisë me

Istanbulsporin apo Arbër Hoxha në atë të Kroacisë me Slaven Belupon e Mirind Daku që është top-shënues në Slloveni me

Muran. Trajneri i Kosovës, Alain Giresse, pritet që ta publikojë listën me futbollistët e ftuar për këto dy takime në ditët e ardhshme.

Liga Unike e femrave fillon më 8 nëntor

Prishtinë, 3 nëntor - Pas Superkupës Mbarëkombëtare të Femrat, Liga Unike në konkurrencën e femrave do t'i fillojë garat për edicionin e ri. Xhiroja e parë do të zhvillohet në mesjavën e ardhshme, më 8-10 nëntor, ku garojnë tri skuadrat më të mira nga Kosova dhe Shqipëria: Prishtina, Partizani i Tiranës, Bashkimi i Prizrenit, Flamurtari i Vlorës, Penza e Pejës dhe Tirana. Kampionia aktuale, Prishtina, në xhiron e parë do të përballet me Tiranën si mysafire në derbin e kryeqyteteve. Në xhiron e parë do ta kemi sfidën në mes të finalistëve të Superkupës Mbarëkombëtare, Flamurtarit dhe Bashkimit, kurse kampionia e Kosovës, Penza, do të ndeshet me fituesin e Kupës së Shqipërisë, Partizanin e Tiranës. Do të zhvillohen dhjetë xhiro, më pas katër skuadrat më të mira do të kualifikohen në "play-off", që do të mbahet në mars të vitit të ardhshëm.



Kosova me dy xhudiste synon medalje në 'Baku 2022'

Prishtinë, 3 nëntor - Kosova do të marrë pjesë me dy garuese në Grand Slamin e Bakusë, i cili do të nisë sot (e enjte). Kosovën në garën prestigjioze të Azerbajxhanit do ta përfaqësojnë garueset Nora Gjakova dhe Lorian Kuka. Nora shihet si pretendente për medalje në kategorinë deri në 57

kilogramë. Medalje do të synojë edhe Lorian në kategorinë deri në 78 kilogramë. Gjakova do të garojë të premtën, kurse Lorian të dielën. Të dyja fituan medalje në Grand Slamin e Abu Dhabit që u mbajt së fundmi. Në këtë garë do të marrin pjesë garues nga mbi 50 shtete të botës me rreth 400 garues.



Formacioni i javës në Ligën e Kampionëve

Nyon, 3 nëntor - Faqja zyrtare e UEFA Ligës së Kampionëve ka publikuar 11-shën më të mirë të rrethit të gjashtë të fazës së grupeve. Të martën dhe të mërkurën u zhvilluan ndeshjet e xhiros

së gjashtë në fazën e grupeve. Formacioni më i mirë i javës, sipas UEFA-s, ka një rreshtim 3-4-3 me futbollistët që kontribuan te skuadrat e tyre përkatëse. Courtois i Real Madridit është në portë. Grimaldo,

Van Dijk e Pavard në fazën e mbrojtjes. Katërshja e mesfushës përbëhet nga Ferran Torres, Kudus, Nkunku dhe Valverde. Sulmit i prijnë treshja Alvarez, Mbappe dhe Giroud.



Krasniqi falënderon Ademin për përkujdesje

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Futbollisti me prejardhje nga Gjakova, Kreshnik Krasniqi, ka vizituar sot presidentin e FFK-së, Agim Ademi. Talenti kosovar, i cili ka lindur dhe rritur në Norvegji, e që njëherësh veprimtarinë prej

futbollisti e zhvillon në Superligën norvegjeze te klubi Stromsgodset, këto ditë ndodhet në Kosovë për pushime. Gjatë vizitës që i bëri shtëpisë së futbollit kosovar, Krasniqi e falënderoi të parin e FFK-së

për përkujdesjen e shtuar ndaj tij pas lëndimit. Ndërkaq, presidenti Ademi e falënderoi futbollistin dardan për vizitën dhe uroi që ai sa më shpejt të rikthehet në formën e tij dhe të performojë me fanellën e

Kosovës ashtu siç ka bërë deri tani. Kujtojmë që futbollisti i Përfaqësues U21 kishte pësuar lëndim në ndeshjen e tij të fundit me këtë grupmoshë ndaj Armenisë në udhëtim në muajin qershor të këtij viti.



Kroosi: Guardiola është trajneri më i mirë në botë

MADRID, 3 NËNTOR - Mesfushori i Real Madridit, Toni Kroos, është një nga temat kryesore të bisedës në kryeqytetin spanjoll këtë sezon. Ylli gjerman po luan futbollin e tij më të mirë ndër vite dhe paralelisht është çështja e hapur nëse ai do të pensionohet në fund të sezonit apo do të vazhdojë të luajë ende. Me Real Madridin që shpesh shtyn më lart në fushë dhe shtimin e Aurelien Tchouameni, Kroos është kthyer në më të mirën e tij në mesfushë, duke zhvilluar lojën për "Los Blancos". Loja e gjermanit e çon Real Madridin më larg nga stil kundërsulmues, i cili ndoshta nuk është pika e fortë e Kroosit. Në fakt, menaxheri që ndoshta më së shumti vlerëson kontrollin në nivelin më të lartë të futbollit është po ai që Kroos e përzgjedhi si më të përshtatshmin për të si lojtar. "Guardiola luftoi deri në ditën e fundit për të më mbajtur në



Bayern. Nëse duhet të zgjidhni një trajner që është perfekt për lojën time, ai është Guardiola. Më pëlqeu vërtet viti me të. Ai më përmirësoi shumë", ka thënë Kroosi për emisionin "Universo Valdano" në "Movistar+". Kroos dhe Pep Guardiola punuan

vetëm për një vit te Bayern Munich në sezonin 2013/14, përpara se ai të shitej te Real Madridi për një tarifë çuditërisht të ulët prej 25 milionë eurosh. Bayerni më pas vazhdoi ta zëvendësojë Kroosin me Xabi Alonson dhe Thiago Alcantaran.

Lakersat buzëqeshin në shtesë, Milwaukee nuk ka të ndalur

LOS-ANXHELOS, 3 NËNTOR - Fitorja e dytë radhazi për lakersat, që këtë herë mposhtën me rezultat 120-117 New Orleansin, fitore që erdhi pas kohës shtesë. Një ndeshje që dukej se po shkonte në favor të miqve, por një tripikësh në sekondën e fundit të kohës së rregullt nga Ryan çoi ndeshjen në shtesë. Më pas, lakersat morën kontrollin dhe fituan (Walker me 28 pikë shënuesi më i mirë). Vazhdon të mos njohë humbje



skuadra Milwaukee, që mundi me rezultat 116-91 Detroitin, në një ndeshje pa shumë histori. Suksesi i shtatë në kampionat për Bucksin mban firmën e të zakonshmit Antetokounmpo, autor i 32 pikëve e 12 reboundeve. Fiton edhe Chicago, që falë një loje të mirë kolektive (6 lojtarë realizuan mbi 10 pikë), mposhti Charlotten me rezultat 106-88. Jashtë fushës fitoi ekipi i clippersave, që mundi

Houstonin (109-101), ndeshje ku u dallua Paul George me 28 pikë. Fitore pas kohës shtesë korri edhe Clevelandi, që mposhti me rezultat 114-113 Bostonin. Për Cavaliersin të gjithë titullarët realizuan mbi 14 pikë (Garland me 29 më i miri. Mirë u paraqit edhe Dallasi, që mposhti me rezultat 103-100 Utah Jazzin, sfidë ku Doniqi realizoi 33 pikë e 11 asistime.

SHKURT

Khaka nominohet për çmimin "Lojtari i Muajit" në Premierligë

Granit Khaka është nominuar për çmimin "Lojtari i Muajit" në Premierligë. Futbollisti me prejardhje nga Kosova ka pasur paraqitje të mira në muajin tetor ku shënoi ndaj Tottenham Hotspurit dhe më pas edhe kundër Southamptonit. Khaka e sheh veten në konkurrencë me treshen e Newcastle Unitedit, Miguel Almiron, Bruno Gumaraes e Kieran Trippier, me yjet e Manchester Cityt, Erling Haalandit e Kevin de Bruynes, portierin e Chelsea, Kepa Arrizabalaga dhe me Leandro Trossardin nga Brighton & Hove Albion.

Nadali eliminohet nga Mastersi i Parisit

Rikthimi në fushë i tenistit spanjoll Rafael Nadal pas një pushimi dymujor (luajti një ndeshje në Laver Cup me Federer) nuk ka qenë ai që pritej. Numri 2 në botë u eliminua që në debutimin e tij në turneun Masters të Paris-Bercy. Nadali u mund 2-1 (3-6, 7-6, 6-1) nga amerikanin Tommy Paul. Ndeshja nisi mirë për spanjollin, por që gaboi në momentet vendimtare të setit të dytë (në tie break). Ndërsa në setin e tretë ishte thuajse inekzistent në fushë, duke u eliminuar që në raundin e dytë. Tashmë Nadal do të përgatitet për finalen e ATP në Torino edhe pse duket e vështirë. Ata që fituan në turneun Masters të Parisit janë greku Stefanos Tsitsipas, spanjollin Carlos Alcaraz (numri 1 në botë), serbi Novak Djoković e bullgari Grigor Dimitrov.

Lukaku rezikon ta humbasë Kupën e Botës

Më shumë mundësi Interi nuk do ta ketë në dispozicion sulmuesin Romelu Lukakun deri më 2023. Ndryshe nga trajneri Simone Inzaghi, trajneri i Belgjikës Roberto Martinez vijon të shpresojë që ta ketë sulmuesin në Kupën e Botës. Lukaku ka fluturuar drejt Belgjikës për t'u vizituar nga mjekët e përfaqësueses. Deri në fillim të javës tjetër Lukaku do t'u nënshtruhet të tjera ekzaminimeve, për ta kuptuar më qartë kohën e rikuperimit. Sulmuesi vështirë se do të paraqitet për Interin këtë vit, kurse prania e tij në Botëror është në dyshim të madh.

Unitedi e gjen në Bayern zëvendësuesin e Ronaldos

Duket se Manchester Unitedi vazhdon të jetë në ndjekje të një sulmuesi për ta zëvendësuar Cristiano Ronaldo, i cili pritet të largohet në janar. Erik Ten Hag ka në mendje shumë emra dhe i fundit për të cilin bëhet fjalë është ai i Eric Maxim Choupo-Moting. Kamerunasi i cili quhej dëshitim disa vjet më parë, po shkëlqen së fundmi me Bayern Munchenin, duke shënuar në gjashtë ndeshje radhazi. Sipas francezes "Media Foot", tekniku holandez e admiron Choupo-Moting dhe u ka kërkuar drejtuesve që ta transferojnë patjetër verën e ardhshme, teksa Bayerni nga ana tjetër kërkon që ta bindë me një tjetër kontratë.

Conte e dëshiron Kanten në Tottenham

Mesfushori N'Golo Kante mund të transferohet në një skuadër tjetër angleze, pasi Tottenham Hotspur ka shprehur interesim për

shërbimet e tij. Lojtari i Chelsea është një nga emrat që është në listën e dëshirave të Antonio Contes. Trajneri i Tottenham

Hotspurit e vlerëson lart mesfushorin francez dhe ka interesim për një nënshkrim me të. Conte dëshiron ta transferojë Kanten si lojtar i

libër gjatë merkatos së verës. Ylli francez vazhdon të jetë jashtë fushave të blerta te Chelsea, pasi vuan nga një lëndim. Kontrata e Kantes te

Chelsea skadon në fund të sezonit. Mbetet të shihet nëse lojtari do të rinovojë me "blutë" ose do të shqyrtojë opsione të tjera.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Drejtorja e Arsimit
14-111/01-0240600/22
Datë: 02.10.2022

Bazuar në nenin 20 paragrafi 1 të Ligjit nr. Nr. 04/L-032 për Arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenin 5 pika (d) të Ligjit nr. 03/L-068 për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, në nenin 4 të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, Drejtorja për Arsim në Komunën e Prishtinës, shpallë:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

- Drejtor/e në SHML "Hoxhë Kadri Prishtina", Prishtinë;
- Drejtor/e në SHML "Gjimnazi i Specializuar Matematikor", Prishtinë;
- Drejtor/e në SHML "7 Shtatori", Prishtinë;
- Drejtor/e në SHML "Sami Frashëri", Prishtinë;
- Zv. Drejtor/e në SHML "Hoxhë Kadri Prishtina", Prishtinë;
- Zv. Drejtor/e në SHML "Gjin Gazulli", Prishtinë.

1. Informata të përgjithshme

- Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit të konkursit më 02.11.2022 deri më datën 16.11.2022;
- Formulari i aplikimit merret në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, në sportelin nr. 5, në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës rr. UÇK-2, 10000, Prishtinë.
- Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës përmes protokollit në Qendrën për Shërbim me Qytetarë;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Për qëllime të arkivimit, i tërë dokumentacioni që dorëzohet për aplikim si kopje fizike, gjithashtu duhet të jetë i skenuar dhe i vendosur në USB (USB-në mund ta merrni prapa pasi të përfundon konkursi);
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuar në MASHTI;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Kandidati/ja në një konkurs publik ka të drejtë të aplikojë në një e më shumë shkolla. Në raste të tilla përgatit dokumentacion të ndarë për secilën shkollë ku aplikon.
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen;
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse.

***Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara me dokumentet e kërkuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.**

2. Kushtet

Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë të kryer arsimin universitar, nivelet e kualifikimit që i plotësojnë kushtet sipas normativit profesional për arsim të përgjithshëm:
 - Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikimin prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
 - Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar);
 - Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
 - Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve¹;
- Të ketë përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASH sipas rekomandimit të KSHLM;
- Të ketë përvojë pune në procesin edukativo-arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës:
 - Pesë (5) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për drejtor në arsimin e mesëm të lartë;

- 2.5.2. Katër (4) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët/et për drejtor/eshë në nivele tjera, dhe
- 2.5.3. Tri (3) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për zëvendës drejtor/eshë.
- 2.6. Për shkollat profesionale të AAP dhe Qendrat e Kompetencës, kandidati/ja duhet jetë me përgatitje profesionale të profileve përkatëse të institucionit ku konkurron.²

3. Dokumentet e kërkuara

Kandidatët duhet të posedojnë dhe dëshmojnë dokumentet, si në vijim:

- Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;
- Certifikatën për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë;
 - Kandidati/ja që ka të përfunduar programin universitar Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim, ofron dëshminë e diplomës Master në këtë fushë të studimeve;
- Kopjen e dokumentit të identitetit (ID).
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Dëshminë se nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënua për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët³;
- Dëshminë për përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor⁴;
- Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike⁵;
- Portfolion profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës⁶;

4. Detyrat dhe përgjegjësitë për drejtorë

Drejtori ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit, duke përfshirë:

- Përgatitjen e planit vjetor, planit zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore të punës;
- Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit për menaxhimin e informatave në arsim dhe respektimin e kodeve të këtij sistemi, procedurave të sigurimit dhe afateve të përcaktuara për përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë vitit shkollor;
- Detyrat e caktuara për zgjedhjen e mësimdhënësve, vlerësimin, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë të arsimit;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kurrikulës;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës së aktiveve dhe bashkëpunëtorëve profesional të institucionit edukativo-arsimor, si dhe mekanizmave tjerë të institucionit arsimor që kanë rol në vlerësimin e performancës së institucionit dhe menaxhimin e cilësisë së punës së institucionit;
- Bashkëpunon me Këshillin drejtues të institucionit edukativo-arsimor (KDSH), Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimtarëve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo-arsimor;
- Raporton së paku dy herë në vit para KDSH;
- Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit në institucionin edukativo-arsimor, duke përfshirë edhe caktimin dhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve, sipas legjislacionit në fuqi;
- Ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave, siç parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH);
- Çështjet e tjera që rregullohen përmes ligjit për arsim parauniversitar, akteve nënligjore të miratuara nga MASH dhe obligimet që dalin nga rregullorja e komunës për arsim.

5. Detyrat dhe përgjegjësitë për zëvendës drejtorë

Zëvendës drejtori i IEAAP ka përgjegjësi të mbështetës dhe ndihmëse punën e drejtorit për të siguruar administrimin dhe mbarëvajtjen e punës së institucionit shkollor, si vijon:

- Përkujdeset dhe përcjell mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe ndihmon në krijimin e klimës pozitive në institucionin shkollor;
- Monitoron dhe mentoron mësimdhënësit në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre;
- Përpunon statistikat e suksesit të nxënësve dhe të dhënat tjera në periudha të caktuara;
- Përgatitë raport periodik për mbarëvajtjen e punës së institucionit shkollor;
- Kontrollon ditaret e klasës së paku njëherë në një periudhë mësimore dhe udhëzon mësimdhënësit për përmirësimin e shënimeve në mënyrën e duhur;
- Ndihmon dhe përkrah mekanizmat e institucionit shkollor për menaxhimin e cilësisë së performancës së institucionit;
- Zëvendëson mësimdhënësit në rastet kur mungojnë;

² Shihni UA 05/2015 Normativi për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional

³ Përpos dokumenteve të cekura në pikën 3.5, DKA Prishtinë do të kërkojë nga Inspektorati për Arsim nëse kandidatët që kanë konkurruar kanë raste të mbyllura apo të hapura kundër tyre.

⁴ Shihni Formularin B/1 për kriteret e pikëzimit të dokumenteve, si dhe Formularin H - Udhëzime për përgatitjen e portfolios profesionale.

⁵ Shihni Formularin I - Model i Deklaratës nën Betim.

⁶ Shihni Formularin H - Udhëzime për përgatitjen e portfolios profesionale, por po ashtu Formularin B/1 rreth kriterëve të pikëzimit të dokumenteve.

¹ Nëse kandidati/ja është në proces të ri-licencimit, të dorëzojë dëshmi nga MASHT për këtë.

- 5.8. Pranon, kontrollon dhe sistemon përgatitjen e planeve mësimore të mësimdhënësve;
- 5.9. Zëvendëson dhe përfaqëson drejtorin/eshën e institucionit shkollor sipas nevojës;
- 5.10. Kryen detyra të tjera të caktuara nga drejtori/ esha i/ e institucionit shkollor, në pajtim me ligjin.

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit/eshës dhe zëvendës drejtorit/eshës mbështeten në ligjet për arsim në fuqi, ato plotësohen edhe me akte të tjera nënligjore që rregullojnë aspekte të veçanta në arsimin parauniversitar në Kosovë.

6. Informimi për qasje në planin zhvillimor të IEAA-së përkatëse

Duke ditur se koncepti i Planit Zhvillimor të institucionit edukativ-arsimor përkatës është një prej pikave të përgatitjes së portofolios profesionale, në linkun e mëposhtëm gjeni Planin zhvillimor të IEAA-ve të Komunës të Prishtinës, si vijon: <https://prishtinaonline.com/drejtore/arsimit/planet-zhvillimore-ieea>

Për çdo problematikë teknike në sigurimin e Planit Zhvillimor të IEAA-së përkatëse, mund të drejtoheni në Drejtorinë Komonale të Arsimit.

7. Vegëzat elektronike

Për të siguruar transparencë dhe barazi maksimale për të gjithë kandidatët, i inkurajojmë të gjithë kandidatet që t'i lexojnë me kujdes të gjitha shtojcat e listuara më poshtë. Këto shtojca janë pjesë përbërëse e procesit përzgjedhës nga Komisioni i emëruar.

Shtojca 1 -Udhëzimi administrativ (MASH) NR.151/2020 për Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm.

Linku:

<https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-mash-nr-151-2020-per-de-tyra-t-dhe-pergjegjese-e-drejtorit-dhe-te-zevendesdrejtorit-te-institucionit-publik-edukativo-arsimor-dhe-aftesues-parauniversitar-ne-republiken-e/>

Shtojca 2- Shtojcat e UA 151/2020 - dukë përfshirë Forumaret të cilat janë kyçe për përgatitjen e kandidatëve, përkatësisht:

- Formulari B - Dokumentet e kërkuara sipas nenit 5 të këtij UA
- Formulari B/1 - Tabela e vlerësimit për kandidatin për drejtor/zëvendës drejtor të IEAAP në bazë të dëshmvive të prezantuara me rastin e konkurimit
- Formulari C - Protokoll i Intervistimit
- Formulari H - Udhëzime për përgatitjen e portfolios profesionale
- Formulari I - Model i Deklaratës nën Betim

Linku: <https://masht.rks-gov.net/shtojca-e-ua-151-1-formularet-per-vlersimin-e-kandidatve-per-drejtor-dhe-zevendesdrejtor-te-iaa/>

Shtojca 3 -Udhëzimi administrativ (MASH) 05/2015 Normativi për Mësimdhësit e Arsimit Profesional

Linku:

<https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-05-2015-normativi-per-mesimdhenesit-e-arsimit-profesional/>

Shtojca 4 - Udhëzues për kandidatët për fazën e intervistave

Qëllimi i këtij dokumenti është që të i jap disa informata kandidatëve rreth mbarëvajtjes së procesit të përzgjedhjes dhe rreth asaj se çka mund të presin kandidatët gjatë ditës së intervistave.

Linku:

https://prishtinaonline.com/uploads/udhezues_per_kandidatet_per_fazen_e_intervistes_per_kandidatet_ne_pozita_udheheqese_te_institucioneve_edukativo-arsimore_.docx.pdf

Shtojca 5 - Dokument informues për vëzhguesit e Komisioneve përzgjedhëse

Për hir të transparencës maksimale për kandidatët, vëzhguesit si dhe qytetarët e interesuar, më poshtë gjeni shtojcën bazë e cila do të përdoret nga Komisioni gjatë punës së tyre, dhe që është në përputhje me UA151/2020.

Linku:

https://prishtinaonline.com/uploads/dokument_informues_per_vezhguesit_e_komisioneve_perzgjedhese.docx.pdf

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Perfect Pizza F” SH.P.K. Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 811580861 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Perfect Pizza F” D.O.O. Mitrovica, donelo odluku o prestani rada sa nr. 811580861 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Perfect Pizza F” L.L.C. with headquarters Mitrovica, has come to the decision to quit its business: 811580861 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Al Design” SH.P.K. Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 810550055 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Al Design” D.O.O. Mitrovica, donelo odluku o prestani rada sa nr. 810550055 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Al Design” L.L.C. with headquarters Mitrovica, has come to the decision to quit its business: 810550055 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Prima Studio” - L.L.C, ka marrë vendim të shuajë biznesin me NUI: 811473280 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë me këtë kompani që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Prima Studio” - d.o.o., donelo odluku o prestani rada sa bisnisom NUI: 811473280 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that “Prima Studio” - L.L.C, has taken the decision to quit its business with NUI: 811473280, The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have creditor – debtor accounts with this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

[lumesdetails](https://www.instagram.com/lumesdetails)

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Heroina Xh. Binaku, shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës Filore nga kl. I deri VIII të shkollës “Naim Frashëri” Gllobar Drenas.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të hollësishëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

